



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.270/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbër Halili, me vendbanim në Prishtinë, kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;03.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar, ankesa e Arbër Halili, me vendbanim në Prishtinë Anr.270/2025, datë;31.01.2025, e parashtruar kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Konservatorët dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë;31.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Arbër Halili, me vendbanim në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, ka përdorur një minibus të pajisur me reklamë (audio) vizuale, në të cilën shfaqen kandidati për kryeministër, Lumir Abdixhiku dhe një kandidat tjetër. Më tej në ankesë theksohet se ky minibus me reklamë të ndriçuar, i cili po qarkullon nëpër qytetin e Prishtinës, ka një ndriçim të fortë dhe po pengon kalimtarët e rastit si dhe vozitësit e automjeteve pavarësisht nga distanca, pasi drita e emetuar është tepër e fuqishme. Parashtruesi shton se nuk ka asgjë kundër zhvillimit të fushatës dhe reklamimit politik, por këto aktivitete sipas tij duhet të jenë brenda kufijve të lejuar dhe të mos paraqesin rrezik për shëndetin e qytetarëve. Reklama të tilla nuk janë vetëm shqetësuese, mund të ndikojnë edhe në sigurinë publike, duke shpërqendruar drejtuesit e automjeteve dhe duke rrezikuar aksidente të mundshme. Reklamimi me ndriçim verbues mund të konsiderohen si shkelje e Kodit të Mirësjelljes, i cili parashikon rregulla të qarta për mënyrën se si subjektet politike mund të zhvillojnë fushatat e tyre, duke përfshirë respektimin e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve. Kërkon të ndërmerren masat e nevojshme për të siguruar që reklamat e përdorura gjatë fushatës zgjedhore të jenë në përputhje me rregulloret ekzistuese,

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 01.02.2025, Subjekti Politik LDK, thekson se pretendimet ankimore se kandidat për deputet, me rastin reklamës vizuale zgjedhore me minibus, kanë shkelur nenin 34 paragrafi 1, nen paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konsiderojnë se ligjërisht nuk qëndrojnë. Në këtë rastet nuk ka të bëjë me asnjë prej kufizimeve të cekura me këtë dispozitë ligjore, sepse kjo formë e reklamimit të materialit zgjedhor është krejtësisht tjetër dhe nuk përben shkelje.

Më tej në përgjigje theksohet se asnjë nga kufizimet e nenit 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nuk ndërliken me rastin në fjalë. Duke marrë parasysh ato që u ceken me lartë kërkojnë nga PZAP-i, që të marr vendim meritör për rastin në fjalë dhe që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se ankesa është e pa bazuar.

Paneli, pas shikimit të fotografive dhe video incizimeve të ofruara si provë materiale, të cilat janë bashkangjitur në ankesë nga Arbër Halili, nga Prishtina, ku pretendon se Subjekti Politik LDK gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, ka përdorur një autobus të pajisur me reklamë (audio) vizuale, në të cilën shfaqen kandidati për kryeministër, Lumir Abdixhiku dhe një kandidat tjetër, paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, përkatësisht neni 7 paragrafi 2 ku shprehimisht thotë: *"Materiali i subjektit politik nuk duhet të vendoset si në vijim: si " 1.2. brenda hapësirës së institucioneve publike, shkollave, objekteve fetare, objekteve në pronësi shtetërore, në monumente, ndërtesa apo objekte banimi, me pëlqimin e banorëve si dhe kur janë të kontraktuara, struktura dhe objekte të cilat kanë vlerë historikë, kulturore ose arkitekturore, brenda ndërtesave dhe zyrave të KQZ-se apo KKZ, brenda qendrave të votimit , ose një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre, brenda zonave rekreative dhe parqeve si dhe ne drenjë.*


Në rastin konkret bëra fushatës nga ana e Subjektit Politik LDK, me autobus të pajisur me reklamë (audio) vizuale, nuk mund të konsiderohet si shkelje e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët si dhe Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, për faktin se një mënyrë e tillë e reklamimit nuk është e ndaluar edhe me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se *"vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve."*

Prandaj Paneli, bazuar në provat e ofruara nga ankuesi, ka arritur në përfundim se bëra fushatë të subjektit politik të lartcekur nuk bie në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 2 Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, lidhur me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të LZP-së,

Mbi arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenin 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i aprovuar ankesat si të bazuara.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
Anr.270/2025, datë;03.02.2025

Kryesuese e Panelit,
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.